



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2021:065887
Datë: 06.12.2024
Numri i dokumentit: 06560500

Ac.nr.2033/2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Hidajete Gashi Alaj, kryetare e kolegjit, Besnik Bislimaj dhe Naime Ahmeti, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditëses Sh.D.nga Vushtrria, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson av. Fatmire Braha nga Vushtrria, rruga “Hasan Prishtina”, nr.62, kundër të paditurës Komuna e Vushtrrisë-Drejtoria Komunale për Arsim, me objekt të padisë kompensim i shujtave për ditët në punë, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës të parashtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë-Dega në Vushtrri, C.nr.348/21, të datës 13.03.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 04.12.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET e pathemeltë ankesa e të paditurës Komuna e Vushtrrisë - Drejtoria Komunale e Arsimit në Vushtrri, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë-Dega në Vushtrri, C.nr.348/21, i datës 13.03.2023, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e atakuar C.nr.348/21 datë 13.03.2023, ka vendosur si vijon: *“I. APROVOHET si e bazuar kërkesëpadia e paditëses Sh.D.dhe DETYROHET e paditura Komuna e Vushtrrisë - Drejtoria për Arsim, që në emër të kompensimit për ushqim në punë për periudhën nga data 21.11.2019 e deri me datë 29.03.2021 t’ia paguaj paditëses Sh.D.shumën prej 484 euro, me kamatë ligjore prej 8%, e cila do të llogaritet nga data 02.04.2021 e deri në pagesën definitive, në afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi e këtë nën kërcënim të përmbarrimit me detyrim. II. DETYROHET e paditura Komuna e Vushtrrisë-Drejtoria për Arsim që paditëses në emër të shpenzimeve të procedurës, t’ia paguaj shumën prej 104.00 euro, për përpilimin e padisë dhe për taksën gjyqësore për padi shumën prej 20.00 euro,*

apo shumën e përgjithshme prej 124.00 euro, në afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, e këtë nën kërcënim të përmbarrimit me detyrim..”.

Kundër këtij aktgjykimi, brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë e paditura, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit ta aprovon si të bazuar ankesën, aktgjykimin e atakuar ta anulodhe çështjen ta vendos në mënyrë meritorë ose të njëjtin ta prish dhe lëndën t’ia kthej rigjykim gjykatës së shkallës së parë.

Paditësja ka paraqitur përgjigje në ankesë me propozim që të refuzohet si e pabazuar ankesa e të paditurës dhe të vërtetohet aktgjykimi i atakuar.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 dhe 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

-Ankesa e të paditurës është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja Sh.D, përmes të autorizuarës së saj, me datë 02.04.2021, në gjykatën e shkallës së parë ka ushtruar padi për kompensimin e shpenzimeve të ushqimit, kundër të paditurës Komuna e Vushtrrisë - Drejtoria Komunale e Arsimit, më arsyet sikurse në padi.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditëses, pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave dhe të të gjitha shkresave tjera të lëndës, në bazë të nenit 398 të LPK-së, (*jashtë seancës*) ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.348/21, të datës 13.03.2023, me të cilin e ka aprovuar në tërësi si të bazuar kërkesëpadinë e paditëses, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të tij.

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar se gjykata përmes kontratës së punës me numër të protokollit 226/2009, të datës 26.09.2014 ka vërtetuar faktin se paditësja është në marrëdhënie pune tek e paditura, ndërsa në bazë të vërtetimit të lëshuar nga SHMU-2 në Vushtrri, të datës 29.03.2021 vërtetoi faktin se për periudhën nga data 21.11.2019 e deri më 29.03.2021, e njëjta ka punuar gjithsej 242 ditë pune. Gjykata ia ka aprovuar kërkesëpadinë e paditëses në bazë të nenit 35 par.7, të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, të datës 18.04.2017 dhe asaj të datës 22.01.2021. Për kamatën ka vendosur bazuar në nenin 382 par. 1 dhe 2 të LMD-së, duke e llogaritur të njëjtën nga dita e parashtrimit të padisë në gjykatë bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020 të datës 02.12.2020. Lidhur me shpenzimet ka vendosur në bazë të nenit 449, 452 dhe 453.2 të LPK-së.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të paditurës se aktgjykimi është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika n) e LPK-së. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike

dispozitivi me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e kërkesëpadisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet përveç atyre jo kontestuese e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë në këtë procedurë kontestimore drejt e ka vërtetuar gjendjen faktike, dhe atë nga kontrata e punës me numër të protokollit 266/2009, të datës 26.09.2014 dhe vërtetimit të datës 29.03.2021 të lëshuar nga e paditura, vërtetoi faktin se paditësja, është në marrëdhënie pune tek e paditura, përkatësisht mësimdhënëse në SHMU-2 në Vushtri dhe për periudhën nga data 21.11.2019 e deri më 29.03.2021, e njëjta ka punuar gjithsej 242 ditë pune.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të të paditurës se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar të drejtën materiale kur ka gjykuar për shpenzimet e ushqimit në punë, për arsye se: Me nenin 90 paragrafi 1 të Ligjit të Punës 03/L-212 i datës 01.11.2010, përcaktohet se: *”Marrëveshja Kolektive mund të lidhet ndërmjet : a) organizatës së punëdhënësve ose përfaqësuesit të tij dhe b) organizatës së të punësuarve ose kur nuk ekzistojnë organizata, marrëveshjen mund ta lidhin edhe përfaqësuesit e të punësuarve”*. Me paragrafin 2 të këtij neni përcaktohet se: *“Marrëveshja Kolektive mund të lidhet: a) në nivel të vendit, b) në nivel të degës dhe c) në nivel të ndërmarrjes”*. Me paragrafin 3 të këtij neni përcaktohet se: *“Marrëveshja Kolektive duhet të jetë në formë të shkruar, në gjuhën zyrtare të Republikës së Kosovës”*. Me paragrafin 5 përcaktohet se: *“Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin për sipër detyrimet e përcaktuara me marrëveshjen e tillë kolektive”*.

Me nenin 35 paragrafi 7, të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017 përcaktohet se: *“Të punësuarve, u sigurohet kompensim për ushqim gjatë punës, për ditë e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë pune, është 2 (dy) Euro për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore. Punëdhënësi, i cili ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve, përmes restaurantit a kuzhinës, ose në një formë tjetër, nuk ka obligim kompensim për ushqim”*. Me nenin 46 paragraf 1 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, përcaktohet se: *“MASHT dhe SBASHK, angazhohen bashkërisht për t’i informuar dhe ndihmuar komunat që të bëjnë planifikimin me kohë të buxhetit dhe kostos financiare për zbatimin e dispozitave të nenit 35 paragrafët 5, 7 dhe 9”*.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të paditurës lidhur me parashkrimin e kërkesës pasi që kjo gjykatë vlerëson se gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka konstatuar se bazuar në Ligjin e Punës, përkatësisht në nenin 87 të tij është përcaktuar se *“Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”*, ndërsa paditësja kërkesën e saj e ka parashtruar për periudhën nga data 21.11.2019 e deri më 29.03.2021, që përfshinë periudhën kur ka qenë në fuqi Kontrata Kolektive e Arsimit e datës 18.04.2017 dhe ajo e datës 22.01.2021, ndërsa padinë e ka paraqitur në gjykatë më 02.04.2021.

Gjykata e shkallës së parë me rastin e aprovimit të kërkesëpadisë së paditëses, duke vendosur decidivisht si në dispozitivin e aktgjykimit të ankimuar, me të drejtë është bazuar në Kontratën

Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017, të lidhur dhe nënshkruar nga Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e Kosovës (SBASHK-ut) dhe Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë e Republikës së Kosovës (MASHT), e cila kontratë ka qenë në fuqi me rastin e parashtrimit të kërkesës për kompensimin e ushqimit-shujtave gjatë ditëve të punës, që nënkupton se kjo Kontratë shërben si akt nga i cili buron themelësia e kërkesëpadisë.

Nga interpretimi i këtyre dispozitave ligjore Gjykata e Apelit erdhi në përfundim se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vërtetuar se në këtë rast ekziston detyrimi juridik - civil, ndaj paditëses në emër të pagesës për kompensimin e shpenzimeve të ushqimit gjatë ditëve të pranisë në punë, për arsye se me nenin 245 paragraf 1 të LMD-së, përcaktohet se: “Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbush atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij”.

Gjykata e Apelit, mori parasysh pretendimin ankimor të të paditurës lidhur me faktin se Kontrata Kolektive e Arsimit nuk është obligative për të paditurën, për arsye se nuk janë përmbushur kushtet e parapara të kësaj Kontrate, meqenëse nënshkruarit e kësaj kontrate siç janë MASHT-i, SBASHK-u dhe Ministria e Financave nuk janë angazhuar asnjëherë për zbatimin e dispozitave që janë implikime financiare. Lidhur me këto pretendime, Gjykata e Apelit vlerëson se referuar dispozitave të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, rrjedh se obligimi për përmbushjen e të drejtave të të punësuarve të parapara me këtë Kontratë, përfshirë të drejtën për kompensim të ushqimit, i takon pikërisht punëdhënësit, që në rastin konkret i bie të jetë Komuna e Prizrenit – Drejtoria Komunale e Arsimit. Në këtë pikëpamje, çfarëdo vështirësie që i atribuohet implikimeve financiare lidhur me zbatimin e kësaj Kontrate, nuk e liron të paditurën nga përgjegjësia për përmbushjen e obligimit në raport me kërkesën e paditëses, gjegjësisht nuk paraqet bazë që kërkesëpadia të trajtohet si e pa themeltë, ndërsa në nenin 2 par.1.2 të Kontratës Kolektive e Arsimit në Kosovë, ndër të tjera thuhet se: “Dispozitat e kësaj Kontrate Kolektive janë të zbatueshme për të gjithë punëdhënësit në sektorin e Arsimit, (Komunat - DKA, KD të Universiteteve e institucioneve të arsimit të lartë, MASHT-in etj.) në sektorin publik dhe institucionet edukativo-arsimore private në mbarë territorin e Republikës së Kosovës...”, ndaj detyrimi për zbatimin e kësaj kontrate ka fuqinë ligjore.

Gjykata e Apelit i ka vlerësuar të papranueshme pretendimet ankimore të paditurës, se kompensimi i kërkuar nga paditësja ngase i njëjti është paraparë me dispozitat e KKAK-së, nënshkruese e të cilës është edhe MASHT-i, andaj e paditura nuk lirohet nga obligimi për pagesën e shumave të gjykuara, sepse kontratat e nënshkruara në mes palëve kanë bazë ligjore në LMD-në, dispozitat përkatës të këtij ligji neni 7 që e rregullojnë materien e çështjes së kontratës, si dhe konform nenit 8 par.1 të LMD-së, ku shprehimisht thuhet “Pjesëmarrësit në marrëdhënien e detyrimit kanë për detyrë ta përmbushin detyrimin e vet dhe janë përgjegjës për përmbushjen e të njëjtit”.

Gjykata e Apelit ka vlerësuar edhe pretendimin ankimor të paditurës për çështjen e detyrimit të saj për të kompensuar paditësen, mirëpo ka ardhur në përfundim se një pretendim i tillë është i pabazuar, për faktin se e paditura qëndron në detyrimin ndaj paditëses edhe pse nuk është

nënshkruese e Kontratës Kolektive të Arsimit të datës 22.01.2021, pasi që në nenin 2 të Kontratës është përcaktuar se kjo kontratë është e zbatueshme edhe për komunat apo DKA-të. Andaj, kjo gjykatë vlerëson se paditësit i ka takuar kompensimi i vendosur sikurse në dispozitivin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejt ka zbatuar dispozitën e nenit 398 të LPK-së i cili shprehimisht përcakton *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë.”* Nga interpretimi i kësaj dispozite ligjore, kjo gjykatë vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejt ka vepruar kur ka gjykuar këtë çështje kontestimore pa shqyrtim kryesor të çështjes pasi janë plotësuar kushtet ligjore në rastin konkret.

Vendimi sa i përket kamatës nga gjykata e shkallës së parë, drejtë është aplikuar e drejta materiale, lartësia e kamatës është në pajtim me nenin 382 të LMD-së dhe llogaritja është bërë saktë në përputhje me Mendimin Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës lidhur me kamatën.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është në përputhje me veprimet e ndërmarra në këtë çështje juridike kontestuese, në përputhje me tarifën për përcaktimin e lartësisë së shpenzimeve dhe në pajtim me dispozitat e LPK-së dhe tarifës së OAK-së.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga të lartë cekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 paragraf 1 pika d), lidhur me nenin 200 të LPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.2033/2023 datë 04.12.2024

Kryetare e kolegjit
Hidajete Gashi Alaj, d.v.